



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. 03-02/DPK	Br Prot. 01-1623/16
Prot. No.	Prot. No.
02	27-04-2016
Date	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.04.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4633/15, për z. Vllaznim Krasniqi, Këshilltar Politik në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Vllaznim Krasniqi, Këshilltar Politik në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, dhe njëkohësisht person i autorizuar në bizneset private D.P.H “New Caffè” dhe N.H.T “Home Garden” ,, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtarët e Agjencisë kanë organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Krasniqi është njoftuar me fakte për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, z. Krasniqi ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për të bërë ndryshimet e kërkuara në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z. Krasniqi ka dërguar në Agjenci shkresat zyrtare të lëshuara nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve (DPKI.03-02/1521/16) (DPKI.03-02/1522/16), me të cilat vërtetohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni menaxherial në bizneset private të lartëcekura. Me këtë rast është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

